Kronikë

Durrës/ Plagosja me armë e 28-vjeçarit për një parkim në Hamallaj, arrestohet 37-vjeçari dhe nipi! Në kërkim i vëllai dhe një tjetër

Dy nga të përfshirët janë arrestuar, dy të tjerë në kërkim. Sipas policisë, 37-vjeçari bashkë me vëllain, nipin dhe një tjetër, ka goditur me sende të forta 28-vjeçarin dhe më pas ka tentuar ta vrasë me armë.

Redaksia
21 Gusht, 09:43 | **Përditësimi: 21 Gusht, 11:34**

Share

Policia e Durrësit ka zbardhur plagosjen me armë të 28-vjeçarit Liridon Rata një ditë më parë në Hamallaj të Durrësit pas një konflikti për parkimin e një automjeti. Në pranga janë vënë Alfons Lekgegaj, 37-vjeç, dhe Armen Sabliqi, 18-vjeç, ndërsa në kërkim janë shpallur Altin Lekgegaj, 44-vjeç dhe Serxho Lekgegaj, 21-vjeç.

Sipas policisë, Alfons Lekgegaj bashkë me vëllain Altin Lekgegaj dhe nipin e tyre Serxho Lekgegaj është konfliktuar fillimisht me sende të forta dhe më pas ka tentuar që të vrasë me armë zjarri 28-vjeçarin. Policia thotë se armën e posedonte pa leje, ndërsa 28-vjeçari ndodhet në spitalin e Traumës jashtë rrezikut për jetën.

Ngjarja është shënuar rreth orës 17:00 të së mërkurës në fshatin Hamallë Sektor, në zonën e bregut të detit, dhe shkak i sherrit ka qenë parkimi i automjetit të 37-vjeçarit përpara zonës së plazhit. Policia ushtroi kontrolle edhe në lokalin e Armen Sabliqit të arrestuar, ku u gjetën edhe dy thika që ai mbante pa leje

LEXO EDHE:
Durrës/ Zjarr në një gomisteri, zjarrfikësit izolojnë flakët (VIDEO)

> *"Nga veprimet e para hetimore rezultoi se më datë 20.08.2025, rreth orës 17:00, në fshatin Hamallë Sektor, Njësia Sukth, Durrës, në zonën e bregut të detit Adriatik, shtetasi A. L., 37 vjeç, në bashkëpunim me vëllanë e tij A. L., 44 vjeç, si dhe nipin e tij S. L., pas një konflikti për motive të dobëta me shtetasin L. R., që lidhej me parkimin e automjetit përpara zonës së plazhit të A. L., 37 vjeç, konflikt i cili fillimisht ka nisur me sende të forta dhe më pas duke përdorur armë zjarri që e mbante pa leje, ka tentuar të vrasë shtetasin L. R., 28 vjeç, banues në Koleshjan, Kukës.", njofton policia.*

Ndaj 37-vjeçarit Alfons Lekgegaj rëndon akuza e tentativës për vrasje me dashje kryer në bashkëpunim dhe armëmbajtje pa leje. Armen Sabliqi akuzohet për veprën penale "Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta", ndërsa ndaj dy të tjerëve në kërkim rëndon akuza e tentativës së vrasjes me dashje të kryer në bashkëpunim dhe dhe të armëmbajtjes pa leje.

Akuzat që rëndojnë ndaj tyre:
Alfons Lekgegaj, 37 vjeç, banues në Hamallë, Durrës, i dyshuar për kryerjen e veprave penale "Vrasja me dashje, mbetur në tentativë, kryer në bashkëpunim" dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, i armëve shpërthyese dhe municioneve".
Armen Sabliqi, 18 vjeç, banues në Borakë, Shijak, i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta". Altin Lekgegaj, 44 vjeç, banues në Hamallë, Durrës, i dyshuar për kryerjen e veprave penale "Vrasja me dashje, mbetur në tentativë, kryer në bashkëpunim" dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, i armëve shpërthyese dhe municioneve".
Serxho Lekgegaj, 21 vjeç, banues në Hamallë, Durrës, i dyshuar për kryerjen e veprave penale "Vrasja me dashje, mbetur në tentativë, kryer në bashkëpunim" dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, i armëve shpërthyese dhe municioneve".

Xh.D/I.M/Shqiptarja.com

TAG: Durres

Komento

Komente

renato: 21/08/2025 12:12

Malokëri e ndyrë.kafshë shpellarë që nuk bëhen njerëz,çfar duan në bregdet shpellarët....

Përgjigju

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Si i vlerësoni kritikat e Ramës ndaj vendimeve të gjyqtarëve?
23 Gusht, 12:25

Të drejta | Të gabuara | Nuk kam mendim

Lajme të tjera

'Festa e Ishmit' mbledh banorë e vizitorë të shumtë! Vlerësohen prodhimet lokale dhe potencialet për turizëm

Aldo Mustafa

24 Gusht, 16:24

Vodhën një makinë dhe një karburant në Sukth të Durrësit, 2 të rinjtë hapin zjarr gjatë ndjekjes ndaj policisë! Njëri plagoset, tjetri prangoset (EMRAT)

24 Gusht, 08:16

Vijon aksioni, Rama ndan pamjet nga lirimi i hapësirave publike në Durrës: Vazhdojmë! (VIDEO)

23 Gusht, 13:53

VIDEOLAJM/ Reshjet e dendura të shiut përmbytën rrugët e Durrësit

22 Gusht, 10:00

Rama ndan pamjet nga kantieri i Muzeut Kombëtar Arkeologjik në Durrës: Do të kthehet në një atraksion të rëndësishëm kulturor

22 Gusht, 08:00

Durrës/ Po udhëtonte drejt Italisë, kapet në port kosovari i dënuar në Zvicër me 27 muaj burg për vjedhje dhe shkelje rrugore! Do ekstradohet

21 Gusht, 13:20

Durrës/ I grabiti me dhunë makinën të riut, arrestohet 31-vjeçari! Mjeti nuk gjendet, dyshime dhe për bashkëpunëtorë (EMRI)

21 Gusht, 11:13

Aksident gjatë natës në Durrës, automjeti humb kontrollin dhe përplaset me 4 të tjera të parkuara! Nuk ka të lënduar (VIDEO)

21 Gusht, 07:09

Durrës/ Plagosi me armë zjarri 28-vjeçarin për vendin e parkimit në Hamallaj, në kërkim autori (EMRI+VIDEO)

20 Gusht, 17:48

Lirohen hapësirat publike në Durrës, Rama ndan VIDEO-n: Ecim

20 Gusht, 15:17

Durrës/ Futi në kurth klientin duke i ofruar s*ks dhe e grabiti bashkë me partnerin, kapet pas 2 ditësh kërkimi 49-vjeçarja! Thyen dhe masën e arrestit

20 Gusht, 14:54

Korriku, muaji me fluksin më të lartë në Portin e Durrësit! 111 mijë pasagjerë, 70 mijë të huaj

Artur Korriku

20 Gusht, 11:19

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje